



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 6.2.2025

Nr: 6

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT PËR
ZGJEDHËSIT ME BANIM BRENDA TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1 shkronja “g” dhe 3, nenit 97 pika 1 dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përmasat e fletës së votimit përcaktohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në varësi të numrit të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilijana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

Data: 6.2.2025 Nr: 6
Ora: 12:00



“Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Lidhja 1

Disa karakteristika të fletës së votimit për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025

Lloji i letrës:

Letër methurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me trashësi 117 micron (µm), me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 420 mm

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra

Logo KQZ, me ngjyra

Ngjyra e fletës së votimit: kod i ngjyrës (CMYK):

(C 0%, M 11%, Y 36% K 0%)

Qr kod (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):

- Qarku 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Qarku

Qendra e votimit



QARKU
QV, Nr.

Zgjedhjet për kuvendin e Shqipërisë
11 Maj 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



FLETË VOTIMI

SPECIMEN